



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosova  
**Komuna e Novobërdës**  
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e shtatë e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 13.11.2018, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë:, Kryesuesja e Komitetit për komunitete Shpresa Kqiku, Anëtarët e Komitetit: Dobrivoje Djordjovic, Aleksander Pavic, Jorgovanka Filic, Abdyl Gashi, Behare Jashari, zv.Kryesuesi i Kuvendit Ramush Mehmeti, ZKKK Sami Vllasaliu, Menaxheri i EccoHigienes Naser Ibrahimimi përfaqësuesit e OSBE-es dhe përfaqësuesit e UNMIK-ut.

Kryesuesja e Komitetit pasi përshendeti të pranishmit tha: e hapi mbledhjen me këtë:

**Rend dite**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Rregullore për punë të komitetit për komunitete;
3. Informim nga njesia EccoHigjena rreth aksionit „Ta pastrojm Kosoven“;
4. Të ndryshme;

Kryesuesja i pyeti se a kan ndonjë propozim apo pajtohen me këtë rend ditë?

Abdyl Gashi pasi përshendeti të pranishmit tha: në mbledhjen e kaluar të komitetit për komunitete u dakorduam bashkarisht që të jenë edhe dy pika në rend dite dhe ato nuk janë futur në rend dite dhe nuk po e di arsyen. E faleminderoj zv.Kryesuesin i cili përfaqëson komunitetin shqiptarë si zv.Kryesues në Kuvendin Komunal por është duhur të jëtë edhe Nënkryetari për Komunitete. Ne seancen e kaluar kemi qenë të kritikuar por kamë qëndruar i përmbajtur duke e ditur përvojën që e ka Kryesuesja e Komitetit dhe jemi akuzuar poashtu edhe nga Nënkryetari dhe një asambleiste e cila është nga subjekti politik i LDK-së për mos punën në komitetin për komunitete, ndoshta kanë pasur të drejt pasi që komitetit për Komunitete asnjëher nuk ka futur një pikë në një seanc të vetme dhe mendoj se atë që e diskutojm të marrim vendim për me i fut në rend dite dhe mos të anashkalohen përseri po them që mos të jemi antarë të komitetit të cilët vetem dëgjojm e mos ta marrim asnjë veprim konkret për pika të caktuara por vetem vin dhe raportoyn për pika të caktuara por ne si komitet nuk nxerrmi asgjë nga këtu, ju faleminderit.

Kryesuesja tha: ato dy pika nuk kanë hy në rend dite pasi që nuk kanë kaluar as në Kuvend edhe pse janë diskutuar.

Abdyl Gashi tha: ne komitetit dhe Kuvendi jemi dy qështje të ndryshme dhe ne si komiete kemi të drejt të kërkojm raport për ndarje të mjeteve të atyre bagëtime pasi që nuk e dim se kujt ju është bërë kompenzimi, kemi të drejt të kërkojm informata për çdo investim.

Zv.Kryesuesi i Kuvendit Ramush Mehmeti pasi përshendeti të pranishmit tha: për herë të parë po marrë pjesë në mbledhje të komitetit edhe pse çdo antarë i Kuvendit ka të drejtë marrë pjesë në Komitet, kanë të drejt të diskutojnë por nuk kanë të drejt vote, në këtë seanc kam ardhur që tju mbështes dhe të ju jap përkrahje aq sa mundem si zv.kryesues dhe unë mendoj se çdo pikë që e propozon komiteti Kuvendit është obligativ që ta fus në rend dite, në at moment që merrni vendim që të dërgoni pika në Kuvend ju Kryesuese jeni obligativ që ti dërgoni propozimet Kryesuesit dhe njëherit jeni obligati që të merrni pjesë në seanc të Kuvendit për ti mbrojtur pikat të cilat i propozon komiteti dhe mendoj se sa do që punohet do të ketë gabime por do të përmirësohen me kalimin e kohës dhe nese mungoj ndonjëher kërkoj falje pasi që jam i ngarkuar me punë në bankë por angazhimi im nuk do të mungoj sa herë që keni nevoj dhe ju uroj punë të mbarë.

Pasi nuk pat diskutime tjera rendi i ditës aprovohet me 5 vota për dhe një kunder (Abdyl Gashi).

**Pika e parë:** Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime procesverbali u aprovua njëzëri nga anëtarët prezent të Komitetit.

**Pika e dytë:** Rregullore për punë të komitetit për komunitete;

Kryesuesja tha: këtë pikë e kam menduar më një qëllim që ne si komitet të mundë të funksionojm më mirë ne kuader të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi dhe ne të punojmë në këtë drejtim dhe në bashkpunim me Nënkryetarin për Komunitete si dhe Zyren për Komunitete dhe Kthim në mënyr që ta pregadisimi në të ardhmen një rregullore si udhërrëfyes për punën tonë të mëtutjeshme por e riceki në bazë të ligjeve në fuqi.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Aleksander Pavic pasi përshendeti të pranishmit tha: para se të kalojm në pikën e dytë është duhur të aprovohet pika e parë pasi që Kryesuesja pyeti se kush ësh për rend dite ne u deklarua por nuk e aprovuam procesverbalin, propozoj të veprojm ashtu si kemi vepruar më herët, njëher aprovimi i rendit të ditës pastaj i procesverbalit e pastaj të vazhdojm më tutje, ju faleminderit.

Dobrivoje Djordjevic tha: pasi që prej OSBE-së e kemi marrë një udhërrëfyes të punës dhe ky udhërrëfyes mendoj se është në bazë të ligjeve dhe normave të aplikueshme në Kosovë, ne mundemi në bazë të këtij udhërrëfyesi të përgadisim një rregullore se si do të funksionojmë ne si komitet dhe mendoj se kjo pikë duhet të shtyhet për komitetin e ardhshëm. Duke pasur parasysh se e kemi këtë udhërrëfyes mendoj se për mbledhjen e ardhshme së bashku me Nenkryetarin dhe zyren e komitetit të punoni dhe të na propozoni një rregullore të brendshme. Pra propozimi im është që këto organe të cilat i përmenda si Kryesuesja e komitetit, Nenkryetari i komuniteteve dhe zyrja për kthim dhe komunitete të punoni në këtë drejtim që për mbledhjen e ardhshme të na bini një propozim rregullore për funksionimin e këtij komiteti, ju faleminderit.

Abdyl Gashi tha: mendoj se kjo pikë si është formuar është formuar gabimisht, ne mundë të punojm një plan të punës ose një plan strategjik e nuk mundemi me nderhy me nxjerr këtu një rregullore kur aty janë të shkruara.

**Pika e parë:** Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime procesverbali u aprovua me 4 vota për 2 nuk votuan nga anëtarët prezent të Komitetit.

Kryesuesja tha: kush është për propozimin e Dobrivoje Djodjevic.

Me 4 vota për, 2 nuk votuan aprovohet propozimi i Dobrivojes për rregulloren e komitetit për komunitete.

**Pika e tretë:** Informim nga njesia EccoHigjena rreth aksionit „Ta pastrojm Kosoven“;  
Për këtë pikë Kryesuesja ja dha fjalen Menaxherit të EccoHigjenes.

Naser Ibrahimimi pasi përshendeti të pranishmit tha: ju e dini se ne e kemi marrë një obligim rreth aksionit ta pastrojm Kosovën dhe e kemi formuar një taksforcë prej Komunës prej 8 antarëve, Kryetar është Sinisa Dimic Nënkryetari i Komunës, antarë janë Shefkije Mehmeti, Naser Ibrahimimi, Sinisa Markovic, Flamur Uka, Sadbere Vllasaliu, Driton Avdyli, Bajram Abazi. Në bazë të kësaj taksforce është bërë një plan i punës për datën 15.09.2018 që të fillohet pastrimi në tërë territorin e Komunës së Novobërdës në të gjitha lagjet ku kanë punuar grupet punuese rreth pstrimit të mbeturinave të ngurta si dhe në fshatra kanë qenë të angazhuar të gjithë banorët si dhe institucionet publike të cilat operojn në vendbanime të ndryshme. Janë grumbulluar 7.3 tonë mbeturina dhe ky aksion nuk do të përfundojë me kaq por do të vazhdojë edhe më tutje. Përkrahja e qytetarëve dhe e institucioneve është shumë e vogël dhe nuk kemi nevojë që çdo lëndë ta dergojm te përmbaruesi për pagesa, me keqardhje e them se çdo herë ne i marrim me vones pagat, andaj ju them të gjithë juve që ta mbajm ambientin më pastërt dhe të jemi më të kujdesëshëm, ju faleminderit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Aleksander Pavic tha: e kam një pyetje për përfaqësuesin e EccoHigjenes, unë jetoj në fshatin Koretisht dhe kam dëgjuar disa brenga të qytetarëve ku ankohen se disa kontinjer të cilët kanë qenë të vendosur më herët në disa pika tani janë larguar dhe më intereson të di se a është kjo e vërtetë dhe pse.

Naser Ibrahimimi tha: po kjo është e vërtetë, gjithashtu e cekim këtë se pa mbështetjen e Komunës ne nuk mundemi të funksionojm, D.SH.P duhet ta marrë për obligim dhe të vendoset një kontinjer aty ku e vendos Komuna, ne e kemi për detyrë me i vendos aty ku i vendos Komuna ne e kemi për detyrë me i pastru ato kontinjer ku janë të vendosur, tjetra është që ata kontinjer ku kanë qenë të vendosur qytetarët vet i kanë tërhequr dhe nuk mundësi të ruajm kontinjerët por duhet të ruajm vet qytetarët.

Abdyl Gashi tha: sa antarë përfaqësojm vullnetar kanë marrë pjesë në këtë aktivitet.

Naser Ibrahimimi tha: atë ditë që kemi zhvilluar këtë aktivitet kanë qenë mbi 150 pjesëmarrës pa e përfshir Pasjakin, Koretishten, Kufcen dhe Stanishorin.

Abdyl Gashi tha: çfarë bashkpunimi ka EccoHigjena me inspeksionin pasi që këto dyja ndërlidhen.

Naser Ibrahimimi tha: ne si kompani mundemi me lajmëru rastin çdo herë por për fat të keq, policia duhet me marrë atë përgjegjësi, tash kanë filluar edhe gjërat të aplikohen dhe çdo kush që shpreh njerz duke hudhur mbeturina e ka mundësinë ta fotografoj dhe të lajmëroj dhe besoj që do të kemi një ambient më të pastërt.

Dobrivoje Djordjevic tha: e kam edhe një pyetje për Drejtorin, në mbledhjen e kaluar të Kuvendit kam kërkuar që të vendosen disa tabela ku ndalohet hudhja e mbeturinave, tash më intereson të di se kush është kompetent për të vendosur këto tabela.

Naser Ibrahimimi tha: ashtu si e thash edhe më herët at obligim e ka Komuna.

Abdyl Gashi tha: më intereson të di se si është mënyra e financimit dhe sa ka buxhet EccoHigjena për një vit dhe pse vonohen pagat.

Naser Ibrahimimi tha: ne faturimin mujor e kemi 6800€. Rreth 4800€ i kemi shpenzime të pagave dhe derivate të naftës pa pasur naj defekt në kamion dhe ne gjithmon mundemi të mbledhim rreth 4300, këta muajt e fundit i kemi mbledhur rreth 7000€ duke i kërcënuar se do të dergojm te përmbaruesi.

**Pika e katërt:** Të ndryshme.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi tha: kërkoj që të futet në rend dite në asamblen e ardhshme të Kuvendit një raport të cilin besoj që edhe do të jetë legjitim, një komision i cili është formuar që të ndaj 5,000€ për familjet e dëmtuara nga vjedhjet e fundit të bagëtive dhe asnjëherë në asnjë mbledhje në asnjë takim nuk jam ftuar dhe nuk e di se ku janë shkuar ato mjete. Në raportin financiar e kam parë se është ndarë shumë dhe janë blerë bagëtit por unë si antarë i atij komisioni asnjëherë nuk jam ftuar dhe nuk kam parë asnjë listë se ku janë shpërndar ato mjete, prandaj që të sqarohet kjo situatë kërkoj që të vij dikush nga zyrja e

Kryetarit apo nga ky komision i cili është formuar që të vij në Kuvend dhe të raportoj se për cilat familje janë ndarë këto mjete, ju faleminderit.

Naser Ibrahim thaj: kërkoi prej komitetit për komunitete që ti shqyrtoj rastet e familjeve të skamnëorëve pasi që gjithëmonë kemi vepruar kështu ka qenë edhe më herët znj. Jorgovanka antare e këtij komiteti dhe nese ka mundësi që tju ndihmoj atyre familjeve. Pasi që Abdyl është pjesë e atij komisioni më mirë kishte me qenë me kërkoi raport prej atij komisioni mirëpo si do që te jetë ky komitet duhet tju del në ndihmë qytetarëve. Unë jam përfaqësues i fshatit Pasjak dhe e kemi një familje shumë të varfër ku qytetarët janë duke ja ndërtuar shtëpinë dhe kërkoi prej këtij komiteti që së paku ti ndihmoj në rregullimin e banjës apo diqka tjetër pasi që me të vertet është në një gjendje të mjerueshme.

Abdyl Gashi thaj: se nashta jam keqkuptuar por nuk kërkova që të vij këtu të raportoj por kërkoi që në asamblen Komunale të raportohet se ku janë ndarë ato mjete.

Zv. Kryesuesi Ramush Mehmeti thaj: mendoi se komiteti për komunitete ka të drejt me rekomandu për në Kuvend ndonjë pikë të caktuar, antari i komitetit propozoi që të raportohet në Kuvend nga komisioni për ndarje të mjeteve familjeve të dëmtuara nga vjedhjet e kafshëve.

Kryesuesja thaj: kush është për propozimin e Abdyl Gashit që të raportohet për ndarje të shumës prej 5,000€ për familjet e demtuar nga vjedhjet e kafshëve që kjo pikë të shkoj në KPF?

Me 4 vota për, 2 apstenim komiteti për komunitete merr vendim që kjo pikë të shkoj në KPF.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falëndëroi të pranishmit për pjesëmarrje.  
Mbledhja përfundoi ne ora 11:00

**Valmire Mustafa**  
Procesmbajtëse



**Shpresa Kqiku**  
Kryesuesë i Komitetit për Komunitete